



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Integritimit Evropian –
Ministarstvo evropskih integracija – Ministry of European Integration

**Udhëzues për konsultime me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e
tjera të interesuara në kuadër të
Organeve të Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë**

Shkurt 2018
Prishtinë

Përmbajtja

HYRJE	3
1. Baza ligjore	3
2. Parimet udhëheqëse	5
3. Procesi përgatitor	6
4. Zhvillimi i konsultimeve: korniza, kontributi dhe procedurat	7
4.1. Korniza e konsultimeve	7
4.2. Kontributi nga konsultimet	8
4.3. Metodologjia dhe procedurat e konsultimeve	10
 <i>Shtojcë: Shpallje publike për regjistrimin e organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara për mekanizmin konsultues në kuadër të Organeve të përbashkëta të Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë</i>		
	15

HYRJE

Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile (OShC-ve) dhe palëve të tjera të interesuara në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë është jetike për të kuptuarit nga ana e tyre dhe për vetëdijesimin e publikut të gjerë për këtë proces dhe për ndikimin e reformave në shoqëri, si dhe për të krijuar hapësirë që ata të kontribuojnë dhe të shfrytëzohet maksimalisht potenciali i saj për zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Ndryshe nga vendet e tjera të Evropës Juglindore në fazën e MSA-së, Kosova po fillon me përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në zbatimin e reformave për aderim në BE qysh në këtë fazë, me qëllim që pjesëmarrja e tyre në këtë proces reformash të avancohet krahas avancimit të procesit të aderimit drejt anëtarësimit të plotë në BE.

MSA, në Preambulë, nënvizon zhvillimin e shoqërisë civile si pjesë të demokratizimit të përgjithshëm dhe si të pandashme nga forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Për më tepër, marrë parasysh që, sipas nenit 1, paragrafit (2a), njëri nga qëllimet e MSA-së është forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës, bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe sektorit publik në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të politikave publike që ndërlidhen me MSA është kyç. Ky raport specifik bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe qeverisë ka për synim vendosjen e një mekanizmi konsultimi për të siguruar që pikëpamjet e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara të reflektohen në mënyrë të duhur në punën e organeve të stabilizim-asociimit (OSA) BE – Kosovë, organe këto të përbashkëta (të krijuara nga MSA), me qëllim të zhvillimit të një qasjeje pjesëmarrëse në zbatimin e reformave që kërkon MSA.

Prandaj, Ministria e Integritimit Evropian (MIE), si institucioni i mandatuar me ligj për të koordinuar zbatimin e MSA-së në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ka zhvilluar një kornizë për konsultime me OShC-të dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të OSA-ve. Si mekanizëm që synon reflektimin e qëndrimeve dhe rolit të tyre në zbatimin e reformave që kërkon MSA, kjo kornizë gjithashtu është dizajnuar për përmbushjen e kërkesave të kornizës ligjore vendore që përcakton përgjegjësitë e institucioneve të Kosovës në kuadër të OSA-ve, si dhe atyre të kornizës ligjore vendore që rregullon konsultimet publike në proceset e politikë-bërjes publike dhe qasjen në dokumente publike. Kjo kornizë për konsultime është dizajnuar në atë mënyrë që të lejojë hapësirë që të evoluojë gjatë kohës derisa procesi i integritimit në BE të sjellë efekte më të thella dhe status formal më të avancuar, duke mundësuar kështu që marrëdhëniet, ndërveprimi, besueshmëria dhe kapacitetet e partnerëve nga të dyja palët në këtë proces (institucionet publike dhe OShC-të e palët e tjera të interesuara) të rriten dhe forcohen në mënyrë që të mund të përballohen sfidat e ardhshme të procesit të aderimit në BE.

Për këtë qëllim, ky udhëzues vendos qasjen ndaj konsultimeve me OShC-të dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të OSA-ve. Ai përbëhet nga katër pjesë. E para përshkruan bazën ligjore, ndërsa e dyta parimet udhëheqëse që rregullojnë këtë kornizë të konsultimeve. Pjesa e tretë përshkruan hapat përgatitorë që do të ndiqen për krijimin e këtij mekanizmi konsultimi. Pjesa e fundit vendos në hollësi hapat proceduralë që do të ndiqen për zhvillimin e konsultimeve në kuadër të secilit OSA, përfshirë afatet dhe përgjegjësitë institucionale.

Udhëzuesi është zhvilluar në konsultim me një numër të përzgjedhur të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara që janë më aktive në procesin e integritimit evropian. Si pjesë e këtij procesi janë mbajtur dy punëtori me këto palë të interesuara. Në këtë gjithashtu kemi përfituar nga përvoja e Republikës së Kroacisë, me përkrahjen financiare të Republikës Federale të Gjermanisë, përmes Projektit *Mbështetje Procesit të Integritimit Evropian në Kosovë*, që zbatohet nga GIZ Kosova.

1. Baza ligjore

Korniza ligjore që përcakton bazën për konsultime me OShC dhe palë të tjera të interesuara në kuadër të funksionimit të OSA-ve përbëhet nga këto akte kryesore:

- Ligji nr. 2010/03-L-215 për Qasje në Dokumente Publike,

- Rregullorja nr. 13/2016 për Funkzionimin dhe Përfaqësimin e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Strukturat e Stabilizim-Asociimit;
- Rregullorja nr. 05/2016 për Standardet Minimale të Procesit të Konsultimit Publik; dhe
- Rregullorja e Punës së Këshillit të Stabilizim-Asociimit.

Ligji për Qasje në Dokumentet Publike ofron bazën ligjore për të drejtën e OShC-ve që të kenë qasje në dokumentet publike që mbahen, hartohen ose pranohen nga ana e institucioneve publike. Në kontekst të shkëmbimit të informatave që lidhen me zbatimin e MSA-së dhe funksionimin e organeve të përbashkëta BE – Kosovë të krijuara përmes saj, nenet 1, 2, 3 dhe 4 të këtij ligji parashohin një bazë ligjore më konkrete për krijimin e organeve dhe/ose procedurave të reja që mundësojnë shkëmbim të rregullt të informatave dhe pikëpamjeve ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara.

Përveç këtij, **Rregullorja nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik** rregullon standardet minimale, parimet dhe procedurat e konsultimeve publike ndërmjet autoriteteve publike, palëve të interesuara dhe publikut të gjerë në proceset e hartimit të legjislacionit dhe politikave publike.

Rregullorja nr. 13/2016 për Funkzionimin dhe Përfaqësimin e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Strukturat e Stabilizim-Asociimit ofron bazë shtesë normative sa i përket rolit të OShC-ve në procesin e zbatimit të MSA-së dhe funksionimit të organeve përbashkëta vendimmarrëse BE – Kosovë që janë përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të saj. Ajo e obligon Qeverinë që të bashkëpunojë me OShC-të dhe palët e tjera të interesuara në tri faza: përgatitjen e mbledhjeve, mbështetjen e zbatimit të reformave të dakorduara përmes tyre dhe monitorimin e zbatimit të tyre. Së pari, kjo rregullore i obligon institucionet përkatëse publike që të përfshijnë OShC-ve dhe palët e tjera të interesuara në *përgatitjen e materialeve të mbledhjeve* të Komitetit të SA-së (neni 14.5), dhe të nënkomiteteve e grupeve të veçanta (neni 18.6). Së dyti, kjo rregullore i obligon institucionet përkatëse publike që të sigurojnë përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuar, në përputhje me ligjin në fuqi, *në zbatimin e konkluzioneve të mbledhjeve* të të gjitha OSA-ve: Këshillit të SA-së (neni 9.9.), Komitetit të SA-së (neni 15.9.) dhe të nënkomiteteve e grupeve të veçanta (neni. 19.9). E fundit fare, kjo rregullore i obligon organet relevante qeveritare që t’u ofrojnë OShC-ve, mediave e palëve të tjera të interesuara dhe publikut të gjerë *qasje në procesverbalet dhe/ose konkluzionet dhe dokumentet tjera relevante* që dalin nga mbledhjet e OSA-ve: Këshillit të SA-së (neni 9.8.), Komitetit të SA-së (neni. 15.8.) dhe të nënkomiteteve e grupeve të veçanta (neni. 19.8).

Baza ligjore e shtjelluar më sipër, që do të funksionalizohet nëpërmjet këtij udhëzuesi, u jep OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara mundësinë sistematike për të kontribuar në reformat që kërkon MSA që nga faza e hershme e prioritizimit dhe planifikimit të tyre, pra para hartimit të agjendave dhe materialeve të tjera të mbledhjeve të OSA-ve. Për më tepër, OShC-të dhe palët e tjera të interesuara, në këtë mënyrë u ofrohet mundësia për të kontribuar në zbatimin e reformave të MSA-së përmes shprehjes së mendimeve të tyre dhe ofrimit të kontributit konkret dhe këshillave në kuadër të një kornize e cila duhet që në masë të madhe të japë rezultate të prekshme në punën e OSA-ve.

Vet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, në veçanti Preambula e saj, nënvizon, në mesin e kërkesave të tjera, zotimin e Kosovës për stabilizim politik, ekonomik dhe institucional, i cili arrihet gjithashtu nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit të përgjithshëm. Me fjalë të tjera, forcimi i shoqërisë civile, si pjesë e procesit të demokratizimit të përgjithshëm, është jessë e pandashme e forcimit të demokracisë dhe vendosjes së shtetit të së drejtës.

Rregullorja e punës (RrP) së Këshillit të Stabilizim-Asociimit është relevante për konsultime me OShC dhe palë të tjera të interesuara në kuadër të OSA-ve pasi që përcakton procedurat dhe proceset për funksionimin e këtyre organeve, përfshirë të gjitha proceset përgatitore dhe të aktiviteteve pasuese, si dhe përgjegjësitë institucionale për detyra specifike dhe afatet kohore për kryerjen e tyre. Ajo parasheh

zhvillimin e mbledhjeve të rregullta të OSA-ve dhe rregullon funksionimin e tyre të përgjithshëm në kontekstin e kryerjes së funksioneve të tyre të përcaktuara nga MSA. RrP gjithashtu përcakton përbërjen dhe detyrat e secilit OSA: neni 3 përcakton se përbërja e synuar e delegacionit të secilës Palë në mbledhjet e *Këshillit të SA-së* dakordohet para mbledhjes përkatëse, dhe se mund të ftojë edhe persona të tjerë për t'i ofruar informata mbi tema të caktuara. Për më tepër, neni 12 përcakton se *Komiteti SA-së* "... përbëhet nga përfaqësues të Bashkimit Evropian nga njëra anë, dhe të Kosovës në anën tjetër, normalisht në nivel të nëpunësve civilë të lartë."

E fundit fare, sipas Shtojcës II të Vendimit për krijimin e *Nënkomiteteve dhe Grupeve të Veçanta* (Vendimit nr. 1/2016, të 25 nëntorit 2016, të Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE - Kosovë për krijimin e nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta), ato përbëhen nga përfaqësues të Komisionit Evropian, Shërbimit Evropian për Veprim të Jashtëm (në rastin e GV për Normalizimin), nga njëra anë, dhe të Kosovës, nga ana tjetër. Pasi që Nënkomitetet dhe SGS rrjedhin nga Komiteti, vlen e njëjta sa i përket përbërjes së përfaqësuesve, pra në nivel të nëpunësve të lartë civilë. Për të diskutuar për tema të veçanta me interes, nëse të dyja palët bien dakord, nënkomitetet dhe grupet e veçanta mund të ftojnë në mbledhjet e tyre ekspertë për të ofruar informata specifike të nevojshme.

Sipas RrP (nenit 6 dhe nenit 5 të Shtojcës), mbledhjet e OSA-ve *nuk janë publike*, përveç nëse vendoset ndryshe.

2. Parimet udhëheqëse

Bashkëpunimi mes Qeverisë dhe OShC-ve në procesin e zbatimit dhe monitorimit të MSA-së bazohet kryesisht në parimet e mirëbesimit dhe transparencës, efektivitetit dhe efikasitetit, dhe ato të besueshmërisë dhe ekspertizës. Ky lloj bashkëpunimi gjithashtu udhëhiqet nga parimet e mishëruara në Rregulloren nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik. Pavarësisht thelbit të bashkëpunimit të hapur dhe transparent në mes të palëve, kjo nuk u ndalon palëve që të zbatojnë parimin e mos-bërjes publike të informatave, sipas nevojës, për shkak të ndjeshmërisë së çështjeve në fjalë.

Mirëbesimi dhe transparenca

Bashkëpunimi mes institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara në proceset e ndërlydhura me MSA-në bazohet në mirëbesim dhe frymë të besimit të ndërsjellë gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij. Të dy palët do të kujdesen në mënyrë të duhur që angazhimi i tyre të mos përfshijë ndonjë aktivitet i cili, në çfarëdo mënyre, me ose pa dashje, do të sillte pasoja negative për cilëndo nga palët e interesuara për të realizuar me efikasitet aktivitetet, obligimet dhe detyrat që dalin nga procesi i zbatimit të MSA-së. Marrë parasysh natyrën e veçantë dhe të ndjeshme të komunikimit dhe të punës së të dyja të përfshira në punën e OSA-ve, si dhe nevojën për konfidencialitet të aspekteve të caktuara të kësaj pune, duhet bërë përpjekje shtesë për të siguruar kryerjen e suksesshme dhe eficiente të këtyre proceseve.

Transparenca e punës së OSA-ve sigurohet në përputhje me dispozitat e Rregullores nr. 13/2016 dhe dispozitat e tjera ligjore dhe kjo do të përfshijë, ndër të tjera, si përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në mekanizmin konsultues, ashtu edhe shpërndarjen e rregullt të procesverbaleve dhe/ose konkluzioneve dhe materialeve të tjera të OSA-ve. Ky parim gjithashtu do të zbatohet në përputhje me Rregulloren nr. 05/2016, përfshirë nenin 17 të saj.

Efektiviteti dhe efikasiteti

Zbatimi i parimit të transparencës në bashkëpunimin ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara do të balancohet me parimin e efektivitetit dhe atë të efikasitetit të punës së OSA-ve në arritjen e një ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatet e këtij procesi. Kjo vihet re me rritjen e

nivelit të shkëmbimit të informatave mes palëve të interesuara, nivelin e cilësisë së të dhënave dhe dokumenteve të krijuara në këtë proces, si dhe të nivelit të asaj se çka përfitojnë institucionet publike nga këshilla, analizat, mendimet dhe vërejtjet e dhëna nga OShC-të dhe palët e tjera të interesuara. Kjo duhet të çojë në rritjen e efikasitetit të punës së OSA-ve dhe të cilësisë së rezultateve të tërë procesit të zbatimit të MSA-së.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara në proceset që ndërlidhen me MSA-në gjithashtu bazohet në përpjekjet e ndërsjella për të kontribuar në përmbushjen në mënyrë efikase të të gjitha detyrimeve që dalin nga MSA, dhe duhet të përmbushet nga ana e të gjitha organeve përgjegjëse për zbatimin e saj. Prandaj është e rëndësishme që i tërë komunikimi nga të dyja palët (institucionet publike dhe OShC-të e palët e tjera të interesuara), përfshirë shkëmbimin e dokumenteve dhe informatave të nevojshme për funksionimin e OSA-ve, të organizohet me kohë dhe në mënyrë efikase. Këto dokumente duhet të organizohen në mënyrën më efikase dhe të marrin sa më pak kohë, në mënyrë që të sigurohet shkëmbimi efikas i informatave që çojnë te vendime të OSA-ve që janë të qarta dhe të marra me kohë. Për më tepër, konsultimet, në aspektin e kohës, strukturës dhe organizimit të tyre, do zhvillohen në atë mënyrë që të mundësojnë shfrytëzimin sa më efikas të kohës dhe hapësirës. Një tjetër qëllim i këtij procesi është që të arrihen rezultate sa më të prekshme dhe produktive që do të rrisin efikasitetin e punës së OSA-ve. Në këtë frymë, të gjitha palët e interesuara duhet të përmbahen nga veprime që mund të shpijnë në çfarëdo lloj pengimi të efikasitetit të funksionimit të OSA-ve.

Të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në punën e OSA-ve bazohen në racionalizim dhe në parimet e kostos së arsyeshme. Për këtë qëllim, të gjitha mbledhjet në kuadër të procesit të konsultimeve ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara do të zhvillohen brenda vendit, dhe për këtë do të shfrytëzohen objektet ekzistuese të institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara të përfshira, pra pa shpenzime buxhetore shtesë. Në të njëjtën linjë, dokumentet dhe materialet e tjera do të shkëmbehen në version elektronik.

Besueshmëria dhe ekspertiza

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara në proceset që ndërlidhen me MSA-në bazohet në të arritura të besueshme të punës dhe në ekspertizë. Kjo është thelbësore për përmbushjen e suksesshme të detyrimeve të MSA-së. Kjo është gjithashtu thelbësore për komunikim të suksesshëm ndërmjet institucioneve publike dhe OShC-ve e palëve të tjera të interesuara në procesin e bashkëpunimit në kuadër të sistemit të krijuar nga MSA. Kjo ndodh për shkakun se përmbajtja e MSA-së ka nivel të lartë të ekspertizës, përfshirë kornizën ligjore, përmbajtjen specifike të nivelit të politikave, si dhe strukturën dhe natyrën e të gjitha aktiviteteve të nevojshme në kuadër të procesit të zbatimit të MSA-së. Në këtë kuptim, një nivel i theksuar i ekspertizës dhe besueshmërisë është thelbësor për të dyja palët (institucionet publike dhe OShC-të e palët e tjera të interesuara) për të arritur mirëkuptimit të ndërsjellë dhe një nivel të dëshirueshëm të konsensusit rreth mënyrave, metodave dhe qëllimeve të cilat do të jenë të nevojshme për të shfrytëzuar dobitë për shoqërinë kosovare nga procesi i zbatimit të MSA-së.

3. Procesi përgatitor

Identifikimi i palëve të interesuara

Identifikimi i palëve të interesuara për procesin e konsultimit të vendosur me këtë udhëzues do të bëhet përmes një *shpalljeje publike* si procedurë zyrtare. Përveç kësaj, marrë parasysh pozitën e caktuar të palëve të caktuara të interesuara (odave ekonomike, sindikatave, universiteteve e instituteve shkencore, etj.) sipas nevojës do të shfrytëzohen edhe mjete të tjera, si mbledhjet e drejtpërdrejta dhe burime të tjera ekzistuese (p.sh., nga baza e të dhënave të CiviKos; baza e të dhënave të Kuvendit të Kosovës, etj.).

Shpallja publike

Në përputhje me atë që u tha më sipër, regjistrimi i OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara për procesin e konsultimit do të kryhet përmes një procesi zyrtar, respektivisht një shpalljeje publike. Ky do të kryhet nga ana e MIE-së, në emër të Qeverisë, dhe do të përbëhet nga tri faza: (1) lansimi/publikimi i shpalljes publike; (2) pranimi i formularëve/kërkesave për regjistrim; dhe (3) njoftimi i entiteteve të regjistruara.

Shpallja publike do të publikohet në gazeta ditore si dhe në ueb-faqen zyrtare të MIE-së dhe të disa OShC-ve, si dhe do të shpërndahet nëpërmjet rrjeteve sociale. Ajo, së bashku me formularin për regjistrim, përfshin hollësi mbi regjistrimin e secilës pale të interesuar për t'u bërë pjesë e mekanizmit të konsultimit për secilin OSA të cilin janë të interesuar ta ndjekin, si dhe kriteret e përzgjedhjes dhe afatet procedurale. Secila organizatë e interesuar për t'u regjistruar si palë e interesit për konsultime duhet të dorëzojë kërkesën/formularin e plotësuar për një ose më shumë OSA më kuadër të fushëveprimit të tyre përkatës, brenda një afati optimal sipas praktikës së Qeverisë për procese të ngjashme. *Shpallja publike* dhe *Formulari për regjistrim* janë pjesë e këtij udhëzuesi (Shtojca).

Pas skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave për regjistrim, MEI do të përpilojë *Listën e palëve të interesuara për mekanizmin konsultues të OSA-ve*, dhe do të përmbyll procesin, *jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune* nga skadimi i afatit të fundit për dorëzimin e kërkesave për regjistrim. Brenda këtyre afateve, MIE do të publikojë në ueb-faqen e saj *Listën e palëve të interesuara për mekanizmin konsultues të OSA-ve*, dhe gjithashtu do të njoftojë, përmes postës elektronike (e-mailit), secilin entitet të regjistruar, duke i ftuar ata zyrtarisht që të bëhen pjesë e këtij mekanizmi të konsultimeve.

4. Zhvillimi i konsultimeve: korniza, kontributi dhe procedurat

4.1. Korniza e konsultimeve

Procesi i konsultimeve ndërmjet institucioneve publike dhe shoqërisë civile e palëve të tjera të interesuara në kuadër të OSA-ve zhvillohet përmes kornizës së mbledhjeve tematike.

Mbledhjet tematike:

- Mbledhin përfaqësues të institucioneve publike të përfshirë në OSA dhe ata të OShC-ve e palëve të tjera të interesuara (entiteteve juridike që merren me çështje të interesuara publik, gjë që përfshin OJQ-të, institucionet akademike [universitetet, institutet kërkimore, etj.] institutet hulumtuese, sindikatat, asociacionet e bizneseve, organizatat për mbrojtje të konsumatorëve, shoqatat e profesionistëve, etj.);
- Shërbejnë si forume bashkëpunimi të përbërë nga anëtarë të OSA-ve (përfshirë kryesuesit dhe sekretarët) dhe përfaqësues të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara;
- Funksionojnë në format të orientuar kah politikat publike përmes përkufizimit të problemeve dhe propozimit të opsioneve për zgjidhjen e tyre, ofrimin të të dhënave relevante për problemet në fjalë dhe analizimit të alternativave;
- Fokusohen në ofrimin e informatave që janë të kuptueshme dhe relevante për punën e OSA-ve;
- Zhvillohen rregullisht, bazuar në kalendarin vjetor të punës së OSA-ve, duke u ofruar palëve të interesuara një pasqyrë të punës së bërë nga OSA-të;
- Organizohen në mënyrë institucionale nga ana e institucioneve relevante publike përgjegjëse për OSA-të përkatëse, në përputhje me Rregulloren nr. 13/2016 dhe RrP të KSA-së.



Grafiku 1: Pasqyrë e organeve të stabilizim – asociimit BE – Kosovë

Pranimi i informatave dhe të dhënave të reja nga OShC-të dhe palët e tjera të interesuara është me dobi për OSA-të që të nxjerrin kontribute të plota substanciale për mbledhjet me BE-në si palë nënshkruese e MSA-së, si dhe për t'i informuar ata mbi rezultatet e mbledhjeve dhe për t'i përfshirë në zbatimin e veprimeve pasuese specifike për zbatimin e reformave të dakorduara, duke krijuar kështu mundësi për bashkëpunim të mëtejshëm.

4.2. Kontributi nga konsultimet

Për të mundësuar përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e zbatimit të MSA-së, përmes këtij udhëzuesi krijohet një mekanizëm konsultimi ndërmjet tyre dhe institucioneve publike për reformat e integritimit në BE, duke u mundësuar atyre të ofrojnë rekomandime rreth politikave publike dhe çështjeve specifike relevante për zbatimin e këtyre reformave përgjatë tërë ciklit (planifikimit, zbatimit dhe monitorimit). Ky mekanizëm konsultimi bëhet funksional përmes dy niveleve të përfshirjes – *informues dhe konsultues* – të organizuar në *mbledhje tematike* para dhe pas mbledhjeve të secilit OSA, që zhvillohen çdo vit. Përmes këtyre mbledhjeve tematike konsultative mundësohet shkëmbimi i informatave dhe konsultime mbi zbatimin e *konkluzioneve të mbledhjeve të vitit paraprak të OSA-ve* përkatëse, si dhe mbi *reformat specifike të diskutuara në mbledhjet e tyre të vitit aktual dhe të dakorduara* aty. Kjo kornizë konsultimesh merr parasysh modelin e [Regjistrimit të BE-së për transparencë](#), siç parashihet në kornizën e [BE-së për rregullim më të mirë](#) për procese transparente dhe [Dokumentin kornizë të OECD-së për konsultime publike](#).

Ky kriter i pjesëmarrjes i përmbush kërkesat e *Standardeve minimale për procesin e konsultimit publik* në kuptimin që OShC-të dhe palët e tjera të interesuara të kenë mundësi të barabarta dhe adekuate për të shprehur shqetësimet e tyre dhe artikulluar qëndrimet në zbatimin e reformave që synojnë përmbushjen e detyrimeve të MSA-së.

Puna në kuadër të këtij mekanizmi konsultimi do të fokusohet në këto aspekte kyçe:

- Vlerësimin e përparimeve të arritura në zbatimin e reformave të dakorduara me BE-në dhe vlerësimin e gjendjes aktuale (përfshirë identifikimin e sfidave kyçe në zbatimin e këtyre reformave dhe adresimin e sfidave të tilla);
- Reflektimin e të gjeturave dhe rekomandimeve të hulumtimeve relevante të politikave në raportet e përgatitura për mbledhjet e rregullta të OSA-ve përkatëse;
- Diskutimin e rolit të mundshëm të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara relevante në ofrimin e mbështetjes për zbatimin e reformave të dakorduara me BE-në, dhe të mënyrave për përfshirjen e tyre;

- Lehtësimin e transparencës së institucioneve dhe llogaridhënies së tyre ndaj publikut përmes mundësimi të qarkullimit dhe shkëmbimit të informatave ndërmjet palëve të interesuara në zbatimin e reformave të dakorduara me BE-në.

Të gjitha kontributet e pranuar nga OShC-të dhe palët e tjera të interesuara gjatë mbledhjeve konsultuese (të dhëna, reagime, komente, rekomandime, sugjerime, etj) për secilin OSA do të trajtohen me vëmendjen e duhur dhe do të shqyrtohen nga ana institucionet përkatëse publike në mënyrë të besueshme. Ata do të shqyrtojnë ato kontribute – analitike dhe përshkruese që janë relevante, specifike dhe që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me zbatimin e reformave të dakorduara nga OSA-të dhe që mund të sjellin vlerë të shtuar në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së.

Nivelet e bashkëpunimit

Në përputhje me bazën ligjore, parimet e përgjithshme dhe kornizën e përgjithshme të bashkëpunimit të paraparë si më lart, ky udhëzues njeh dy nivele kryesore në të cilët do të përfshihen OShC-të dhe palët e tjera të interesuara në zbatimin dhe monitorimin e MSA-së. Në mesin e disa dokumenteve ligjore, dispozitat e detyrueshme të Rregullores nr. 13/2016 (të parapara në paragrafin 8 të nenit 9, paragrafin 8 të nenit 15, paragrafin 9 të nenit 9 dhe paragrafin 9 të nenit 15, paragrafin 5 të nenit 14 dhe paragrafin 6 të nenit 18) përcaktojnë më për së afërmi nivelet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, në njërën anë, dhe OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara, në anën tjetër, në procesin e zbatimit të MSA-së nëpërmjet OSA-ve.

Shkëmbimi i informatave

Niveli i parë i bashkëpunimit i detyron institucionet relevante publike që t'u ofrojnë OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara qasje në këto informata:

- Kalendarët e mbledhjeve të rregullta të OSA-ve;
- Temat dhe çështjet që do të diskutohen në mbledhjet e rregullta të OSA-ve;
- Konkluzionet/procesverbalet e mbledhjeve të rregullta të OSA-ve;
- Dokumente të tjera relevante të OSA-ve, sipas nevojës dhe kërkesave, bazuar në legjislacionin mbi funksionimin e OSA-ve dhe legjislacionin tjetër relevant.

Në kuadër të këtij niveli, para dhe pas mbledhjeve të rregullta të OSA-ve institucionet relevante publike do t'u ofrojnë OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara udhëzimet e nevojshme për t'u përgatitur për tema specifike që do të diskutohen.

Konsultimet

Ky mekanizëm konsultimi u ofron OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara një kanal zyrtar dhe sistemit që:

- Të shtojnë ndikimin e tyre në procesin e integritit në BE përmes shfrytëzimit të analizave, të dhënave cilësore e sasiore, mendimeve, rekomandimeve dhe llojeve të tjera të kontributit të tyre në zhvillimin e dokumenteve punuese që përgatiten për mbledhjet e OSA-ve;
- Të paraqesin pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre në përcaktimin e agjendës së reformave konkrete për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së;
- Të rrisin përfshirjen e tyre në procesin e integritit në BE duke kontribuar në zbatimin e reformave të rëna dakord në mbledhjet e OSA-ve, përmes këshillave, rekomandimeve, sugjerimeve dhe mendimeve, brenda një kornize kohore që do të sjellë rezultate konkrete dhe të prekshme në përmbushjen e detyrimeve të MSA-së; dhe

- Të kontribuojnë në llogaridhënien, transparencën dhe vetëdijesimin e të gjithë palëve të interesuara dhe publikut të gjerë për zbatimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së.

4.3. Metodologjia dhe procedurat e konsultimeve

Qasja e përcaktuar në këtë udhëzues kërkon krijimin e një forumi formal me pika konkrete të aktiviteteve dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të palëve të interesuara të përfshira nga të gjitha sferat (institucionet publike, nga njëra anë, dhe OShC-të e palët e tjera të interesuara, në anën tjetër). Ky mekanizëm konsultimi do të mbledhë përfaqësues të institucioneve publike të përfshira në OSA dhe OShC-ve e palë të tjera të interesuara të identifikuar përmes shpalljes publike dhe formave të tjera të shtjelluara në kapitullin 3 më sipër.

Sekretariati i secilit OSA gjithashtu shërben si sekretariat i mbledhjeve tematike në kuadër të OSA-ve, të paraqitur në *Grafikun 1* më sipër. Mbledhjet konsultuese tematike do të organizohen dhe kryesohen bashkërisht nga Bashkëkryesuesit, Zëvendës-bashkëkryesuesit dhe Sekretarët e OSA-ve përkatës nga pala kosovare. Detyrat dhe përgjegjësitë e tyre janë:

- Të organizojnë mbledhjet konsultuese, përfshirë ofrimin e mbështetjes së nevojshme teknike;
- Të përgatisin agjendat dhe materialet e tjera të mbledhjeve dhe t'ua shpërndajnë ato të ftuarve në mbledhje konsultuese;
- Të kryesojnë diskutimet gjatë mbledhjeve konsultuese;
- Të përgatisin procesverbalet e takimit;
- Të përgatisin dhe shpërndajnë konkluzionet e mbledhjeve konsultuese;
- Të mirëmbajnë dokumentacionin dhe informatat e tjera, dhe t'u ofrojnë ato palëve të interesuara e interesit të përfshira në konsultime, sipas nevojës, edhe për qëllime të lehtësimit të monitorimit të zbatimit nga ana e tyre të konkluzioneve të OSA-ve.

Lista e temave/çështjeve të mbledhjeve të rregullta të OSA-ve përkatëse, bazuar në agjendën e këtyre mbledhjeve, do t'u shpërndahen përfaqësuesve të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara që kanë marrë pjesë në mbledhjet përkatëse konsultuese tematike.

Kontributet e ofruara nga ana e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara mund, sipas rastit, të përfshihen në dokumentin zyrtar përfundimtar që dorëzohet për mbledhjen përkatëse të OSA. Në raste kur kontributet e ofruara nuk do të përfshihen, për shkak të pamundësisë për të verifikuar burimin ose diferencuar të dhënat, kjo do të diskutohet në mbledhjet përkatëse konsultuese tematike. Kontributet e ofruara mund, sipas rastit, të përfshihen në dokumentin zyrtar, së bashku me një sqarim lidhur me burimin dhe metodën e përdorur.

Bazuar në MSA-së, Rregulloren e punës së KSA-së dhe Rregulloren nr. 13/2016, me këtë udhëzues parashihen mbledhje konsultuese tematike me OShC dhe palë të tjera të interesuara në kuadër të këtyre OSA-ve:

- *Komitetit të Stabilizim-Asociimit;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Bujqësi dhe Peshkatari;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit Nënkomiteti për Drejtësi, Liri dhe Siguri;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Inovacioni, Shoqëri të Informacionit dhe Politika Sociale;*
- *Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal;*
- *Grupit të Veçantë të Stabilizim-Asociimit për Reformë të Administratës Publike; dhe*

- *Grupit të Veçantë të Stabilizim-Asociimit për Normalizim.*

Konsultimet në kuadër të Këshillit të Stabilizim-Asociimit

Siç është vendosur nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme, i cili është institucioni përgjegjës për Këshillin e Stabilizim-Asociimit, ky udhëzues nuk parasheh konsultime në kuadër të këtij OSA.

Konsultimet në kuadër të Komitetit të Stabilizim-Asociimit

Sipas Rregullores nr. 13/2016 (neneve 14.4., 15.8. dhe 15.9.), Ministria e Integrimit Evropian, si kryesuese e Komitetit nga pala kosovare, do të zhvillojë konsultime me OShC dhe palë të tjera të interesuara të regjistruara për këtë OSA. Kjo përfshin ofrimin atyre qasje në konkluzionet/procesverbalet e mbledhjeve të rregullta të Komitetit dhe në dokumente të tjera relevante, sipas nevojës, si dhe të qenit të hapur për mundësi të bashkëpunimit me ta në zbatimin e aktiviteteve të dala nga konkluzionet/procesverbalet e mbledhjeve të rregullta dhe lehtësimin e këtij lloji bashkëpunimi.

Brenda kornizës së mbledhjeve të rregullta të Komitetit do të ftohen dy mbledhje konsultuese. Në to do të marrin pjesë anëtarë të Komitetit dhe sekretariati nga pala kosovare, si dhe përfaqësues të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara të regjistruara për konsultime në kuadër të Komitetit sipas procesit përgatitor të përshkruar në kapitullin 3 më sipër.

Mbledhja e parë konsultuese

Me qëllim që OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara t'u ofrohen informatat përkatëse, si dhe që të kontribuohet në cilësinë e konsultimeve dhe shkëmbimit të opinioneve ndërmjet tyre dhe institucioneve publike, së civile, dokumentet relevante për punën e Komitetit do të shpërndahen me kohë.

Afatet kohore:

- Mbledhja e parë konsultuese në kuadër të Komitetit do të mbahet *brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas hartimit të agjendës preliminare të mbledhjes së tij të rregullt;*
- Ftesat për mbledhjen e parë konsultuese, së bashku me rendin e ditës të mbledhjes dhe dokumentacionin tjetër, do t'u dërgohen të ftuarve *jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së mbledhjes së parë konsultuese.*

Mbledhja e parë konsultuese në kuadër të Komitetit do të mbahet në kuadër të përgatitjeve për mbledhjen e tij të rregullt, me fokus në:

- Diskutimin dhe pranimin e kontributit të palëve të interesuara rreth vlerësimit të gjendjes aktuale në fushat që mbulon Komiteti; dhe
- Diskutimin dhe pranimin e kontributit të palëve të interesuara rreth pikave të rendit të ditës të propozuara.

Dokumentet që do të ndahen para mbledhjes së parë konsultuese në kuadër të Komitetit janë:

- Konkluzionet e mbledhjes së rregullt paraprake;
- Pjesët relevante të dokumenteve planifikues kombëtarë për aderim në BE (PKZMSA-së, ERA-s, etj.);
- Raporti vjetor i KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Raportet relevante mbi gjendjen aktuale (raportet mbi zbatimin e PKZMSA-së, raportet mbi zbatimin e ERA-s, kontributet për Raportin vjetor të KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Dokumente të tjera (sipas nevojës/kërkesës).

Mbledhja e dytë konsultuese

Në mënyrë që OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara t'u ofrohen informata relevante, dhe që të kontribuojnë në cilësinë e konsultimeve dhe shkëmbimit të opinioneve ndërmjet tyre dhe institucioneve publike, dokumentet relevante për punën e Komitetit do të shpërndahen në kohën e duhur.

Afatet:

- Mbledhja e dytë konsultuese në kuadër të Komitetit do të mbahet *brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas finalizimit të konkluzioneve të mbledhjes përkatëse të rregullt;*
- Ftesat për mbledhjen e dytë konsultuese, së bashku me rendin e ditës të mbledhjes dhe dokumentacionin tjetër, do t'u dërgohen të ftuarve *jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së mbledhjes së dytë konsultuese.*

Mbledhja e dytë konsultuese do të fokusohet në diskutimin e reformave të marra përsipër nga ana e Kosovës për t'u zbatuar dhe rolit të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara të përfshira në konsultime për të mbështetur zbatimin e tyre dhe për monitorimin e këtij procesi, konkretisht në:

- Prezantimin dhe diskutimin e konkluzioneve të mbledhjes së rregullt të Komitetit dhe masat pasuese të dakorduara aty;
- Njoftimin e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara mbi rezultatet e kontributit të tyre nga mbledhja e parë konsultuese;
- Diskutimin e rolit të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në zbatimin e konkluzioneve të mbledhjes së rregullt të Komitetit.

Dokumentet që do të ndahen para mbledhjes së dytë konsultuese në kuadër të Komitetit janë:

- Konkluzionet e mbledhjes së rregullt të Komitetit;
- Pjesët relevante të dokumenteve planifikues kombëtar për aderim në BE (PKZMSA, ERA, etj.);
- Raporti vjetor i KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Raportet relevante mbi gjendjen aktuale (raportet mbi zbatimin e PKZMSA-së, raportet mbi zbatimin e ERA-s, kontributet për Raportin vjetor të KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Dokumente të tjera (sipas nevojës/kërkesës).

Të dy mbledhjet konsultuese do të organizohen sipas kalendarit vjetor të mbledhjeve të OSA-ve, të dakorduar me institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian.

Përgjegjësitë:

- Institucioni përgjegjës: Ministria e Integritimit Evropian;
- Institucionet pjesëmarrëse: institucionet relevante të përfshira në punën e Komitetit, sipas Rregullores nr. 13/2016.

Konsultimet në kuadër të Nënkomiteteve dhe Grupeve të Veçanta të Stabilizim-Asociimit

Në bazë të Rregullores nr. 13/2016 (neneve 18.6., 19.8 dhe 19.9.), Ministria e Integritimit Evropian, si dhe, përkatësisht Ministria e Administratës Publike dhe institucioni i Qeverisë përgjegjës për dialogun me Serbinë, në kapacitetin e tyre si kryesues të nënkomiteteve dhe grupeve të veçanta përkatëse nga pala e Kosovës, do të zhvillojnë konsultime me OShC-të dhe palët e tjera të interesuara të regjistruara për OSA-të përkatëse. Kjo përfshin ofrimin atyre qasje në konkluzionet/procesverbalet e mbledhjeve të rregullta të OSA-ve përkatës dhe në dokumente të tjera relevante, sipas rastit, si dhe që të jenë të hapur për mundësinë e bashkëpunimit me ta në realizimin e aktiviteteve të dala nga konkluzionet/procesverbalet e mbledhjeve të rregullta të OSA-ve, dhe lehtësimin e këtij bashkëpunimi.

Në kuadër të mbledhjeve të rregullta vjetore të secilit Nënkomiteti dhe Grupi të Veçantë të Stabilizim-Asociimit, do të ftohen dy mbledhje konsultuese. Në to do të marrin pjesë anëtarët e Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës dhe Sekretariatit të tij nga pala e Kosovës, si dhe përfaqësues të OShC-ve dhe

palëve të tjera të interesuara të regjistruara për konsultime në kuadër të secilit Nënkomiteti / Grupi të Veçantë, sipas procesit përgatitor të përshkruara në *pjesën 4.3* më sipër.

Mbledhja e parë konsultuese

Në mënyrë që OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara t'u ofrohen informata relevante, dhe që të kontribuojnë në cilësinë e konsultimeve dhe shkëmbimit të opinioneve ndërmjet tyre dhe institucioneve publike, dokumentet relevante për punën e Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës do të shpërndahen në kohën e duhur.

Afatet:

- Mbledhja e parë konsultuese në kuadër të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës do të mbahet *brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas hartimit të agjendës preliminare të mbledhjes së rregullt të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës;*
- Ftesat për mbledhjen e parë konsultuese, së bashku me rendin e ditës të mbledhjes dhe dokumentacionin tjetër, do t'u dërgohen të ftuarve *jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së mbledhjes së parë konsultuese.*

Mbledhja e dytë konsultuese

Në mënyrë që OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara t'u ofrohen informata relevante, dhe që të kontribuojnë në cilësinë e konsultimeve dhe shkëmbimit të opinioneve ndërmjet tyre dhe institucioneve publike, dokumentet relevante për punën e Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës do të shpërndahen në kohën e duhur.

Afatet:

- Mbledhja e dytë konsultuese në kuadër të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës do të mbahet *brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve të punës pas finalizimit të konkluzioneve të mbledhjes së rregullt të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës;*
- Ftesat për mbledhjen e dytë konsultuese, së bashku me rendin e ditës të mbledhjes dhe dokumentacionin tjetër, do t'u dërgohen të ftuarve *jo më vonë se pesë (5) ditë pune para ditës së mbledhjes së dytë konsultuese.*

Mbledhja e dytë konsultuese do të fokusohet në diskutimin e reformave të marra përsipër nga ana e Kosovës për t'u zbatuar dhe rolit të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara të përfshira në konsultime për të mbështetur zbatimin e tyre dhe për monitorimin e këtij procesi, konkretisht në:

- Prezantimin dhe diskutimin e konkluzioneve të mbledhjes së rregullt të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës dhe masat pasuese të dakorduara aty;
- Njoftimin e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara mbi rezultatet e kontributit të tyre nga mbledhja e parë konsultuese në kuadër të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës;
- Diskutimin e rolit të OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në zbatimin e konkluzioneve të mbledhjes së rregullt të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës.

Dokumentet që do të ndahen para mbledhjes së dytë konsultuese në kuadër të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës janë:

- Konkluzionet e mbledhjes së rregullt të Nënkomitetit / Grupit të Veçantë përkatës;
- Pjesët relevante të dokumenteve planifikues kombëtar për aderim në BE (PKZMSA, ERA, etj.);
- Raporti vjetor i KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Raportet relevante mbi gjendjen aktuale (raportet mbi zbatimin e PKZMSA-së, raportet mbi zbatimin e ERA-s, kontributet për Raportin vjetor të KE-së për Kosovën (pjesët relevante);
- Dokumente të tjera (sipas nevojës/kërkesës).

Të dy mbledhjet konsultuese do të organizohen sipas kalendarit vjetor të mbledhjeve të OSA-ve të dakorduar me institucionet përkatëse të Bashkimit Evropian.

Përgjegjësitë:

- Për Nënkomitetet:
 - Institucioni përgjegjës: Ministria e Integrimit Evropian;
 - Institucionet e tjera pjesëmarrëse: institucionet relevante sipas Rregullores nr. 13/2016.
- Për grupet e veçanta:
 - Institucionet përgjegjëse: Ministria e Administratës Publike (për GV për RAP) dhe institucioni i Qeverisë përgjegjës për dialogun me Serbinë;
 - Institucionet e tjera pjesëmarrëse: institucionet relevante sipas Rregullores nr. 13/2016.

Shtojcë: Shpallje publike për regjistrimin e organizatave të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara për mekanizmin konsultues në kuadër të Organeve të përbashkëta të Stabilizim-Asociimit BE – Kosovë

Në pajtim me Rregulloren nr. 13/2016 mbi Funksionimin dhe Përfaqësimin e Institucioneve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Strukturat e Stabilizim-Asociimit dhe Rregulloren nr. 05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, Ministria e Integrimit Evropian nxjerr këtë:

SHPALLJE PUBLIKE PËR REGJISTRIMIN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE DHE PALËVE TË TJERA TË INTERESUARA PËR MEKANIZMIN KONSULTUES NË KUADËR TË ORGANEVE TË PËRBASHKËTA TË STABILIZIM-ASOCIIMIT BE – KOSOVË

I. Konteksti

Rregullorja nr. 13/2016 e detyron Qeverinë që të bashkëpunojë me OShC-të dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të OSA-ve: në përgatitjen e mbledhjeve të OSA-ve, në mbështetjen e zbatimit të reformave të dakorduara në këto mbledhje dhe në monitorimin e zbatimit të tyre. Rregullorja nr. 05/2016 përcakton standardet minimale, parimet dhe procedurat e konsultimit publik ndërmjet autoriteteve publike, grupeve të interesuara dhe publikut të gjerë në proceset e hartimit të legjislacionit dhe të politikave.

Prandaj, pjesëmarrja e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara është me rëndësi jetike për të kuptuarit e përgjithshëm të MSA-së, si dhe për zhvillimin dhe zbatimin e reformave dhe për të siguruar ndikim pozitiv të këtij të fundit në zhvillimin e shoqërisë sonë. Duke promovuar në mënyrë aktive rolin e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e integrimit evropian, ky mekanizëm konsultimi krijon hapësirë për përfshirjen e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara në zbatimin e MSA-së. Qëllimi i këtij mekanizmi konsultues është që të sigurohet që pikëpamjet e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara të pasqyrohen në mënyrë adekuate në kuadër të punës së OSA-ve, me synimin drejt një qasjeje pjesëmarrëse në zbatimin e reformave që kërkon MSA.

II. Mbledhjet konsultuese tematike

Përmes kësaj shpalljeje ftohen përfaqësuesit e OShC-ve dhe palëve të tjera të interesuara që të regjistrohen për të marrë pjesë në konsultime të rregullta në kuadër të një (1) ose më tepër OSA, duke caktuar një (1) përfaqësues në mbledhjet konsultuese për secilën OSA me interes për to.

Regjistrimi është i hapur për konsultime në kuadër të këtyre OSA-ve:

- *Komitetit të Stabilizim-Asociimit (Komitetit)* (fushëveprimi: të gjitha fushat në kuadër të MSA-së);
- *Nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit (NKSA) dhe Grupeve të Veçanta të Stabilizim-Asociimit (GVSA):*
 - *NKSA për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime* (fushëveprimi: Produktet industriale; Çështjet tregtare; Standardizimi, metrologjia, akreditimi, certifikimit, vlerësimi i konformitetit dhe mbikëqyrja e tregut; Bashkëpunimi në fushën e industrisë; NVM-të; Turizmi; Doganat; Tatimet; Rregullat e origjinës; Asistenca e ndërsjellë administrative në çështjet doganore);
 - *SASC për Bujqësi dhe Peshkatari* (fushëveprimi: Produktet bujqësore; Produktet e peshkimit; Produkteve bujqësore të përpunuara, Verërat; Mbrojtja e treguesve gjeografikë për produkte dhe ushqime bujqësore dhe të peshkimit përveç pijeve alkoolike; Sektori i bujqësisë dhe ai agro-industrial, çështjet veterinarë dhe ato fitosanitare; Bashkëpunimi në fushën e peshkatarisë);
 - *NKSA për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë* (fushëveprimi: E drejta e themelimit të kompanive; Ofrimi i shërbimeve; Çështje të tjera që lidhen me Kreun IV të MSA-së; Përafrimi i legjislacionit dhe zbatimi i ligjit; Konkurrenca; Pronësia intelektuale,

- industriale dhe komerciale; Prokurimi publik; Bankat, shërbimet e sigurimit dhe shërbime të tjera financiare; Mbrojtja e konsumatorit);
- *NKSA për Çështjet Ekonomike e Financiare dhe Statistika* (fushëveprimi: Pagesat rrjedhëse dhe lëvizja e kapitalit; Politikat ekonomike; Bashkëpunimi në fushën e statistikave; Promovimi dhe mbrojtja e investimeve; Bashkëpunimi financiar);
 - *NKSA për Drejtësi, Liri dhe Siguri* (fushëveprimi: Fuqizimi i institucioneve dhe sundimit të ligjit; Të drejtat themelore, përfshirë anti-diskriminimin dhe mbrojtjen e të dhënave; Bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile dhe penale; Vizat, kontrolli kufitar, azili dhe migrimi; Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm, ripranimi; Shpëlarja e parave; Drogat; Luftimi i terrorizmit; Parandalimi i krimit të organizuar dhe aktiviteteve të tjera të paligjshme);
 - *NKSA për Inovacion, Shoqëria të Informacionit dhe Politika Sociale* (fushëveprimi: Kushtet e punës dhe mundësitë e barabarta; Bashkëpunimi në fushën e çështjeve sociale; Arsimi dhe trajnimet; Bashkëpunimi në fushën e kulturës; Bashkëpunimi në fushën e politikave audiovizuale; Shoqëria e informacionit; Rrjetet dhe shërbimet e komunikimit elektronik; Informimi dhe komunikimi; Hulumtimet shkencore dhe zhvillimi teknologjik);
 - *NKSA për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal* (fushëveprimi: Transportit, Energjia; Mjedisi; Ndryshimet klimatike; Mbrojtja civile; Zhvillimi rajonal dhe lokal);
 - *GVSA për Reformën e Administratës Publike* (fushëveprimi: reforma e administratës publike); dhe
 - *GVSA për Normalizim* (fushëveprimi: Përmirësimi i dukshëm dhe i qëndrueshëm i marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë, dhe bashkëpunimi efektiv me misionin PPSM të BE-së gjatë shërbimit të tij).

III. Kriteret dhe e drejta për regjistrim

Secila organizatë që kërkon të regjistrohet për këtë mekanizëm konsultimi është e obliguar të përmbushë këto kritere:

- Të jetë e regjistruar dhe veprë në territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës, ose një ligj tjetër në fuqi;
- Të jetë aktive gjatë së paku një (1) viti para nxjerrjes së kësaj shpalljeje publike;
- Të veprë në të paktën njërin nga fushat e përvijuara në pjesën II të kësaj shpalljeje publike, më sipër (e përcaktuar me Statut/dokument tjetër relevant ligjor të organizatës).

Kufizimet e regjistrimit:

- Secila organizatë që kërkon të regjistrohet për konsultime në fusha politikash jashtë fushëveprimit të OSA-ve, të përvijuara në pjesën II të kësaj shpalljeje, më sipër, nuk ka të drejtë ta bëjë këtë;
- Secila organizatë që kërkon të regjistrohet nuk mund të përfaqësohet nga më tepër se një (1) person për një OSA. Ato mund të përfaqësohen nga një (1) përfaqësues në më shumë se një (1) OSA;
- Secila organizatë që kërkon të regjistrohet nuk mund të përfaqësohet nga persona që garojnë dhe/ose janë të zgjedhur në poste politike;
- Të punësuarit me orar të plotë të çfarëdo institucioni publik që merret me cilëndo nga fushat e politikave të përvijuara në pjesën II të kësaj shpalljeje, më sipër, nuk kanë të drejtë të përfaqësojnë ndonjë organizatë që kërkon të regjistrohet për këtë mekanizëm konsultues;
- Secili person nuk ka të drejtë të përfaqësojë më tepër se një (1) organizatë që kërkon të regjistrohet për këtë mekanizëm konsultues.

Nëse asnjë organizatë nuk dorëzon kërkesë(a) për regjistrim në një (1) ose më shumë nga OSA-të (për fushat e politikave të përvijuara në pjesën II të kësaj shpalljeje, më sipër), MIE mund të nxjerrë përsëri këtë shpallje publike. Ajo gjithashtu mund ta nxjerrë këtë përsëri kur të ketë nevojë për të përditësuar listën e palëve të interesuara për këtë mekanizëm konsultimi.

IV. Mandati

Organizatat e regjistruara dhe përfaqësuesit e tyre bëhen automatikisht anëtarë të mekanizmit të konsultimit në kuadër të organeve të stabilizim – asociimit BE – Kosovë për një periudhë kohore deri kur ky udhëzues të shfuqizohet nga Qeveria. Mandati i një përfaqësuesi të një organizate të regjistruar për këtë mekanizëm konsultimi mund të përfundojë para skadimit të tij në rast të:

- Dorëheqjes së saj/tij nga ky mekanizëm konsultues;
- Dorëheqjes së saj/tij nga pozita në organizatën të cilën janë regjistruar ta përfaqësojnë;
- Dështimi të përfaqësuesit të organizatës për të marrë pjesë në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme konsultuese;
- Kërkesës së organizatës që përfaqësojnë për ta zëvendësuar atë me një përfaqësues tjetër.

Në rast se krijohen vende të lira për arsyet e përmendura në këtë pjesë, MIE mund të nxjerrë përsëri këtë shpallje publike.

V. Procedura dhe dokumentacioni për regjistrim

Procedura e regjistrimit për këtë mekanizëm konsultimi synon të ruajë balancën mes *përfaqësueshmërisë* (duke u mundësuar të gjitha palëve të interesuara që të regjistrohen për OSA-të që bien në kuadër të fushëveprimit të misionit të tyre), dhe *ekspertizës* (duke vendosur kritere minimale që duhet përmbushur si nga organizatat ashtu edhe përfaqësuesit e tyre në këtë mekanizëm konsultimi).

Secila organizatë obligohet të dorëzojë këto dokumente:

- Formularin e regjistrimit – të plotësuar (pjesën VI të kësaj shtojce); dhe
- Certifikatën e regjistrimit të organizatës.

Pas pranimin të kërkesave për regjistrim, MIE do të përpilojë *Listën e organizatave të regjistruara për mekanizmin konsultues me OShC dhe palë të tjera të interesuara në kuadër të organeve të stabilizim-asociimit BE – Kosovë jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pune pas skadimit të afatit* për dorëzimin e kërkesave për regjistrim. Ajo do ta publikojë këtë listë në ueb-faqen e saj zyrtare dhe do t'i njoftojë organizatat përkatëse përmes postës elektronike, duke i ftuar kështu zyrtarisht që të bëhen pjesë e këtij mekanizmi konsultues.

Procedura e përshkruar në këtë pjesë do të ndiqet edhe në rastet kur nxirret përsëri kjo shpallje publike.

Ju lutemi të dorëzoni Formularin për regjistrim (të plotësuar dhe nënshkruar) në format **elektronik** (te mei@rks-gov.net) ose në format të shtypur – personalisht ose përmes postës (në zyrat e MIE-së, adresa: Ndërtesa kryesore e Qeverisë, Kati VIII, Zyra 806, 10000 Prishtinë, Kosovë) **deri të premten, më 9 mars 2018, në 16:00**, sipas kohës lokale.

VI. Formulari për regjistrim

Ju lutem plotësojeni këtë formular në mënyrë të plotë dhe siç kërkohet. Gjithashtu u kërkohet të dorëzoni një numër dokumentesh mbështetëse bashkangjitur këtij formulari. Ju lutemi që gjithashtu të lexoni *Udhëzuesin për konsultime me organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesuara në kuadër të organeve të stabilizim-asociimit BE – Kosovë.*

Vetëm formularët e plotë për regjistrim, së bashku me listën e plotë të dokumenteve mbështetëse të kërkuara, do të merren parasysh. Sipas nevojës, gjithashtu mund të ju kontaktojmë drejtpërsëdrejti për të ju kërkuar që të ofroni të dhënat dhe/ose dokumentet e kërkuara. Ju lutem të kini parasysh se në rast shtrembërimi dhe ofrimi të të dhënave të rreme përbën bazë për ndjekje penale.

Informata të përgjithshme		
Emri dhe shkurtesa e organizatës:		
Informatat zyrtare për kontakt (adresa postare, ueb-faqja, numri (at) i(e) telefonit, adresa elektronike/emaili):		
Data zyrtare e themelimit / data e regjistrimit:		
Numri i regjistrimit (numri i dhënë në certifikatën e regjistrimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës i Qeverisë):		
Udhëheqësja/i e/i organizatës (emri, pozita, numri i telefonit, adresa e postës elektronike/emaili):		
Informata specifike		
Fusha(t) e interesit (sipas organeve të stabilizim-asociimit)		
Komiteti i Stabilizim-Asociimit (Komiteti)	Po <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
	Jo <input type="checkbox"/>	
Nënkomiteti i SA për Tregti, Industri, Dogana dhe Tatime	Po <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
	Jo <input type="checkbox"/>	
Nënkomiteti i SA për Bujqësi dhe Peshkari	Po <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
	Jo <input type="checkbox"/>	
Nënkomiteti i SA për Treg të Brendshëm dhe Konkurrencë	Po <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____
	Jo <input type="checkbox"/>	

	Jo <input type="checkbox"/>	Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Nënkomiteti i SA për Çështje Ekonomike e Financiare dhe Statistika</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Nënkomiteti i SA për Drejtësi, Liri dhe Siguri</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Nënkomiteti i SA për Inovacion, Shoqëri të Informationit dhe Politika Sociale</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Nënkomiteti i SA për Transport, Energji, Mjedis dhe Zhvillim Rajonal</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Grupi i Veçantë i SA për Reformën e Administratës Publike</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____
<i>Grupi i Veçantë i SA për Normalizim</i>	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>	Nëse po , ju lutemi jepni këto informata: Përfaqësuesja/i e/i caktuar Emri: _____ Pozita: _____ Informatat për kontakt (emaili dhe nr. i telefonit): _____

Unë, e/i nënshkruara/i, në emër të organizatës që drejtoj, jam e/i vetëdijshme/ëm se pjesëmarrja jonë në mekanizmin konsultues në kuadër të organeve të stabilizim-asociimit BE – Kosovë (të themeluar nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, MSA), do të jetë në pajtim me parimet e mirëbesimit dhe transparencës, efektivitetit dhe efikasitetit, dhe besueshmërisë dhe ekspertizës. Të gjitha informatat e marra në këtë proces do të trajtohen në përputhje me këtë, dhe nuk nuk do të publikohen ose përdoren për qëllime të tjera, pa pëlqimin e personave fizikë dhe/ose juridikë në përgjegjësi për udhëheqjen e punës së këtyre organeve institucionale.

Udhëheqësja/i e/i organizatës:

Emri: _____

Pozita: _____

Data: _____

Vendi: _____

Nënshkrimi: _____